

1101prot
11.04.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 253/1 Prot.

Shkodër, më 09.04.2025

Lënda: Mbi Vendimin nr. 11, datë 26.03.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 27, pika 6, neni 54, shkronja "n", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 30, pika 4, shkronjat "b" dhe "c", të ligjit nr. 9693 "Për fondin kullosor", neni 26, shkronja "c", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, neni 32, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar, pika 51, shtojca 49, shqyrtoi VKB Fushë Arrëz nr. 11, datë 26.03.2025 "Për miratim e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025 në territorin administrative të Bashkinë Fushë Arrëz".

Për sa trajtuar më sipër, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 963 prot.

Fushë-Arrëz, më 1. 04. 2025

VENDIM

Nr. 11, datë 26. 03. 2025

"PËR

**MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE
SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA PËR VITIN 2025 NË
TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ"**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar ; Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet"; neni.30, pika 4, shkronja c ; Ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri" ; VKM-në nr.134 datë 3.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive" të ndryshuar, si dhe referuar Shkresës Nr.707 prot., datë 19.03.2025 "Dërgim për miratimin e Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025" nga DAPK, Sektori Emergjencave Civile dhe MZSH, Bashkia Fushë-Arrëz, Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz, në mbledhjen e datës 26.03.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025.
2. Bashkëlidhur këtij vendimi janë Plani i Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025 dhe Skema e ndërlidhjes.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, Sektori i Emergjencave Civile dhe MZSH, Bashkia Fushë-Arrëz.
4. Ky vendim u shpall me datë 1. 04. 2025 dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

9 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstënim

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al